



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
612-26-4551-2-1-1/C708

KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

DEA GROUP SH.P.K., PRISHTINE, KOSOVO, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore (zbatues) të nevojshme për Komunën e Fushë Kosovës me numër identifikues: **612-26-4551-2-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore (zbatues) të nevojshme për Komunën e Fushë Kosovës

1	Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore (zbatues) të nevojshme për Komunën e Fushë Kosovës
----------	--

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porositë" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorin shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Autoriteti Kontraktues mban të drejtën e porosisë për hartimin e projekteve sipas fazave të ndryshme dhe në kushte të caktuara të cilat paraqiten si pasojë e zhvillimeve aktuale dhe urgjente andaj duhet të merret parasysh nga ana e Kontraktuesit që të jetë në gjendje gatishmërie në çdo kohë varësisht nga natyra e punës që kërkohet në kuadër të shërbimeve.

1.5 Harmonizimi i procedurave për Leje ndërtimore, të cilat rezultojnë me harmonizimin e dokumentacionit teknik dhe dokumenteve tjera nga autoritetet nga niveli lokal dhe qendror-marrja e pëlqimeve janë obligim i Drejtorive përkatëse të cila parashirojnë kërkesë për projekte dhe se çdo kërkesë plotësuese dhe shpenzimet tjera rreth procedurës me qëllim të kompletimit dhe kërkesave shtesë janë obligim i Kontraktorit.

1.6 Ofruesi i shërbimeve obligohet që ta hartoj projektin kryesor- zbatues të kontraktuar sipas detyrave projektuese dhe ti përmbahet vërejtjeve të dhëna nga Ekipi për Menaxhimin e Kontratës dhe organeve kompetente.

1.7 Nëse kontraktuesi nuk i kryen shërbimet e hartimit të projektit në përputhje të plotë me detyrën projektuese ose substancialisht i kryen punët ndryshe nga detyra projektuese do të përgjigjet për përmbushje të parregullte të kontratës dhe /ose për kundërvajtje ekonomike.

1.8 Projekti kryesor (për ekzekutim) duhet të punohet sipas Standardeve, Ligjit të Ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

1.9 Projektet e punuara duhet të dorëzohen në 3 (tri) kopje të forta dhe 1 (një) kopje elektronike në formatin (PDF, DWG, WORD dhe EXEL apo ndonjë format tjetër i cili lidhet me ndonjë softuer specifik për projektim) si dhe me CD.

1.10 Kontrata hynë në fuqi me **31.08.2026** dhe përfundon në datën **30.08.2028**.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **30** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes dhe pranimit të kërkesës nga Ekipi për Menaxhimin e Kontratës i caktuar ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të shërbimeve do të jetë Objekti i Komunës së Fushë Kosovës.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Çmimi i peshuar i ofertës është **67.47** Euro. (Gjashtëdhjetë e shtatë euro e katërdhjetë e shtatë cent).

Vlera e parashikuar e kontratës është **150,000.00 €** (Njëqind e pesëdhjetë mijë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar

dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Valon Prebreza	Emri:	Ismete Prebreza
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ	Pozita:	U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	31.07.2026	Data:	31.07.2026
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	ARTON ZEQIRI
Pozita:	DIREKTOR
Nënshkrimi:	
Data:	31/07/2026
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofruesi i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozionet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjанuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjë palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkatoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Ekipi për Menaxhimin e Kontratës do të caktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim të ZKA-së.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 15,000.00 € ne kohëzgjatje prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: N/A a) Mjetet motorike të Palës së Tretë b) Përgjegjësia e pales së tretë c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve d) Përgjegjësia profesionale e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Ekipi për Menaxhimin e Kontratës i caktuar nga Autoriteti Kontraktues
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Palët do të përpiqen që çdo mosmarrëveshje në mes tyre ta zgjidhin në mënyrë miqësore nga Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, personave përgjegjës të AK-së si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga Operatori Ekonomik.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në pajtim me ligjin në Kosovë.

Hartimi i projekteve detale						
	Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma
	A					
35%	A	Hartimi i projekteve Konceptuale dhe Ideore . duke e perfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore. -Projektet duhet të projektohet dhe kompletohet konform detyës projektuese të përpiluar nga investitori ,Ligjit të ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës ,të dorëzoet në 3 kope fizike dhe CD				
	1	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti për objekte. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m ²	1	1.30€	1.30 €
	2	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti për hapësira te jashtme: terene sportive, sheshe, parqe, fusha te futbollit, stadione etj. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m ²	1	1.10€	1.10 €
	3	Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE TË OBJEKTEVE . -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m ²	1	1.00€	1.00 €
	A	TOTALIA :				3.40 €
	B					
	B	Hartimi i projekteve Kryesore dhe zbatuese (Objekte Banimi, Administrative, Shkollore, Shoqërore, Sportive, Shëndetësore, Ekonomike, Kulturore ,Nenkalime dhe mbikalime,garazha nentokësore etj). duke e perfshire edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore. (Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqe të bazës të projektuar) -Projektet duhet të projektohet dhe kompletohet konform detyës projektuese të përpiluar nga investitori ,Ligjit të ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës ,të dorëzoet në 3 kope fizike dhe CD				
	1	Punimi i projektit kryesor - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit	m ²	1	2.50€	2.50 €
	2	Punimi i projektit kryesor - Statika konstruksioni dhe stabiliteti i objektit.	m ²	1	1.00€	1.00 €
	3	Punimi i projektit kryesor të Hidroinstalimeve.	m ²	1	0.20€	0.20 €
	4	Punimi i projektit kryesor Instalimet Elektrike.	m ²	1	0.20€	0.20 €
	5	Punimi i projektit kryesor të instalimeve Makinerike.	m ²	1	0.20€	0.20 €
	6	Punimi i projektit kryesor të masave mbrojtëse për siguri të objektit, masat kundër zjarrit.	m ²	1	0.20€	0.20 €
	7	Projektimi i Enterierit.	m ²	1	0.20€	0.20 €
	8	Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE TË OBJEKTEVE. / duke perfshire edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m ²	1	1.00€	1.00 €
	B	TOTALI B :				5.50 €




	C					
C	Hartimi i projekteve kryesore -zbatuese për hapësira të hapura publike - Terene të hapura - duke përfshirë edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terrenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore.(Sipërfaqja e projektimit të llogaritet për sipërfaqe të bazës të projektuar) <i>-Projektet duhet të projektohet dhe kompletohet konform detyës projekteuse të përpiluar nga investitori ,Ligjit të ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës ,të dorëzoet në 3 kope fizike dhe CD</i>					
1	Projektimi i tereneve sportive - të hapura. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	1.50 €	1.50 €	
2	Projektimi i shesheve. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	1.50 €	1.50 €	
3	Projektimi i parqeve, kendeve për fëmijë etj. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	1.50 €	1.50 €	
4	Projektimi i rrethojave. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	1.50 €	1.50 €	
5	Projektimi i fushave të futbollit-stadiume. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	4.50 €	4.50 €	
6	Projektimi i venparkingjeve. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	1.50 €	1.50 €	
C	TOTALI C :				12.00 €	
	D					
D	Hartimi i projekteve Kryesore -zbatues për objekte ekzistuese - Renovime, nderhyrje, rikonstruime, sanime etj (Objekte Banimi, Administrative, Shkolllore, Shoqërore, Sportive, Shëndetësore, Ekonomike, Kulturore etj). duke e përfshirë edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terrenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore. <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqe të bazës të projektuar)</i> <i>-Projektet duhet të projektohet dhe kompletohet konform detyës projekteuse të përpiluar nga investitori ,Ligjit të ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës ,të dorëzoet në 3 kope fizike dhe CD</i>					
1	Incizimi i objekteve ekzistuese (ARKITEKTURA), dhe përpilimi i projektit arkitektonik për objektet ekzistuese.	m²	1	3.50€	3.50 €	
2	Incizimi i objekteve ekzistuese-STATIKA, dhe përpilimi i projektit të Statikës për objektet egzistuese.	m²	1	0.20€	0.20 €	
3	Incizimi i objekteve ekzistuese-ELEKTRIKA, dhe përpilimi i projektit të ELEktrikes për objektet egzistuese .	m²	1	0.20€	0.20 €	
4	Incizimi i objekteve ekzistuese-MAKINERIA, dhe përpilimi i projektit të Makinerise për objektet egzistuese.	m²	1	0.20€	0.20 €	
5	Incizimi i objekteve ekzistuese-UJESJELLESË DHE KANALIZIMI, dhe përpilimi i projektit të (Ujesjellesi&Kanalizimi) për objektet egzistuese.	m²	1	0.20€	0.20 €	
D	TOTALI D :				4.30 €	
	TOTALI (A+B+C+D) :				25.20 €	



E						
60%	E	Hartimi i projekteve Kryesore për Rrugë dhe objektet e rruges - duke përfshirë edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore. <i>-Projektet duhet të projektohet dhe kompletohet konform detyës projektuese të përpiluar nga investitori ,Ligjit të ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës ,të dorëzoet në 3 kope fizike dhe CD</i>				
	1	Projektim i rrugëve me 1 dhe 2 Korsi. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.50 €	2.50 €
	2	Projektim i rrugëve me 3 dhe 4 Korsi . -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.50 €	2.50 €
	3	Projektimi i Urave deri 10 m. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	28.00 €	28.00 €
	4	Projektimi i Urave mbi 10 m. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	28.00 €	28.00 €
	5	Projektimi i nenkalimeve dhe mbikalimeve. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	3.00 €	3.00 €
	6	Projektimi i Mureve Mbrojtëse. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	4.00 €	4.00 €
	7	Projektimi i sinjalizimit të rrugëve. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	1.00 €	1.00 €
	8	Projektimi i trotuareve. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.50 €	2.50 €
	9	Projektimi i shtigjeve për biçikleta. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.50 €	2.50 €
	10	Projektimi për rregullimin e nyjeve të komunikacionit. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	1.50 €	1.50 €
	E	TOTALI E:				75.50 €
F						
	F	Hartimi i projekteve Kryesore -zbatuese për Trajtim të Ujërave - duke përfshirë edhe Matjet gjeodezike, inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike varësisht që plotësojnë nivelin e projektit si bazë planore. <i>-Projektet duhet të projektohet dhe kompletohet konform detyës projektuese të përpiluar nga investitori ,Ligjit të ndërtimit dhe UA që janë në fuqi në Republikën e Kosovës ,të dorëzoet në 3 kope fizike dhe CD</i>				
	1	Projektimi i Kanalizimit Fekal . -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.00 €	2.00 €
	2	Projektimi i Kanalizimit Atmosferik. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.00 €	2.00 €
	3	Projektimi i Rrjetit të Ujësllësit. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.00 €	2.00 €
	4	Projektimi i rrjetit të telefonise, internet etj . -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.00 €	2.00 €
	5	Projektimi i shtratit të perroit / lumenjeve. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)	m²	1	2.00 €	2.00 €
	6	Projektimi i impianteve për trajtimin e ujërave -(Çmimi i projektimit të llogaritet për vëllimin e projektuar)	m³	1	2.00 €	2.00 €
	7	Projektimi i rrjetit elektrike dhe ndriçimit publik Nentoksor apo mbitoksor. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m'	1	2.00 €	2.00 €
	8	Projektimi i Rezervoarve - të Ujit. -(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)	m³	1	2.00 €	2.00 €
	F	TOTALI F:				16.00 €
TOTALI (E+F):					91.50 €	



H					
5%	H	Punimi i Elaborateve per nevoja te Autoritetit Kontraktues			
	1	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik <i>-(Çmimi bëhet duke u bazuar në (m') thellësinë e shpimeve gjeomekanike të paraqitura në Elaborat Gjomekanik).të dorëzohet në 3 kope fizike dhe CD</i>	m'	1	65.00 € 65.00 €
	2	Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike , inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike ne baze te kerkeses se AK per m' per nevoja konkrete.(Ky pozicion nenkupton vetem kur kerkohen matjet gjeodezike si projekt I veqante sepse te gjitha pozicionet tjera jane te parapara se bashku me matje gjeodezike) <i>- Çmimi bëhet për gjatësinë e projektuar me Elaborat gjeodezik ,të dorëzohet në 3 kope fizike dhe CD</i>	m'	1	1.80 € 1.80 €
	3	Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike , inqizimi i terenit dhe përpilimi i të gjitha bazave gjeodezike ne baze te kerkeses se AK per sipërfaqet per nevoja konkrete.(Ky pozicion nenkupton vetem kur kerkohen matjet gjeodezike si projekt I veqante sepse te gjitha pozicionet tjera jane te parapara se bashku me matje gjeodezike) <i>- (Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqe të bazës të projektuar me Elaborat gjeodezik)të dorëzohet në 3 kope fizike dhe CD</i>	m²	1	1.80 € 1.80 €
	4	Hartimi i Elaboratit (Raportit) për Leje Medisore Komunale ,të dorëzohet në 3 kope fizike dhe CD <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)</i>	m²	1	0.50 € 0.50 €
	5	Hartimi i Elaboratit (Raportit) për Leje Medisore Komunale ,të dorëzohet në 3 kope fizike dhe CD <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)</i>	m'	1	0.50 € 0.50 €
	6	Hartimi i Raportit për Vlerësimin Ndikimit në Mjedis ,të dorëzohet në 3 kopje fizike dhe CD dhe të zhvillohen të gjitha pocedurat përcjellëse të parapara me UA në fuqi , deri sa të paiset AK me Pëlqim Mjedisor dhe Leje Mjedisore. <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)</i>	m²	1	0.50 € 0.50 €
	7	Hartimi i Raportit për Vlerësimin Ndikimit në Mjedis ,të dorëzohet në 3 kopje fizike dhe CD dhe të zhvillohen të gjitha pocedurat përcjellëse të parapara me UA në fuqi , deri sa të paiset AK me Pëlqim Mjedisor dhe Leje Mjedisore. <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për gjatësinë e projektuar)</i>	m'	1	0.50 € 0.50 €
	8	Hartimi i Elaboratit për mbrojtje nga zjarri ,të dorëzohet në 3 kopje fizike dhe CD dhe të zhvillohen të gjitha pocedurat përcjellëse të parapara me UA në fuqi , deri sa të paiset AK me Pëlqim. <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)</i>	m²	1	0.50 € 0.50 €
	9	Hartimi i Elaboratit për efqienc të energjisë në ndertesa ,të dorëzohet në 3 kopje fizike dhe CD. <i>-(Çmimi i projektimit të llogaritet për sipërfaqen e projektuar)</i>	m²	1	3.80 € 3.80 €
H		TOTALI H :			74.90 €
		TOTALI (H) :			74.90 €



	Rikapitullim i Përgjithshëm	%	Çmimi total i pa peshuar	Çmimi total i peshuar $F=C \cdot D$
	Totali nga (A+B+C+D): i projektimit për të gjitha pozicionet (35%) e pikëve për vlerësim)	35,00%	25.20 €	8.82 €
	Totali nga (E+F): i projektimit për të gjitha pozicionet (60%) e pikëve për vlerësim)	60,00%	91.50 €	54.90 €
	Totali nga (H): i projektimit për të gjitha pozicionet (5 %) e pikëve për vlerësim)	5,00%	74.90 €	3.75 €
	Çmimi total	100%	191.60 €	67.47 €
	Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila duhet të shenohet te PJESA C: FORMULARI I DORËZIMIT TË TENDERIT dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.			67.47 €

Vërejtje:
Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës, oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjeshme
Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuar në Kosovë
Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Pagesat do të bëhen vetëm në bazë të porosisë nga AK (Detyrës Projektuese nga ana e Menaxherit të Kontratës. Detyra projektuese do të përbajë pozicionet e paramasës së mësipërme se cilat pozicione do të paguhën për projektin në fjalë).



DATA: 02.07.2026
VENDI: PRISHTINË

DEKLARATA E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

Kompania: DEA GROUP SH.P.K nga Prishtina cakton
z.DRITON MURIQIN menaxher të projektit:

Autoriteti Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Titulli: **Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore (zbatues) të nevojshme për Komunën e Fushë Kosovës**

Nr.Prokurotimit: 612-26-4551-2-1-1

z. DRITON MURIQI me përvojë pune 15 vjeçare me titull Ing. i Dip. i Arkitekturës ka qenë menaxher i projekteve të ndryshme, që ka bërë kompania DEA GROUP SH.P.K dhe ka eksperiencë të më hershme në këtë pozitë pune, të cilat i ka përfunduar me afat të parapar sipas autoritetit kontraktues.

DEA GROUP SH.P.K
PRISHTINË



Ing.i Dip. i Arkitekturës
DRITON MURIQI

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'D. Muriqi', is written over a horizontal line.



Dega PËRPARIM MUJA B.I.

Numri i polices 060480010103754

1 Të dhënat për agentin - Agent details

Emri dhe mbiemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Përparim Muja	Prishtinë, Rruga Isa Boletini, Nr.59	044368333	048001

2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë

I SIGURUARI	DEA GROUP SH.P.K.		
Adresa	Rr. Prekazi 36 Prishtine		
Përfaqësuar nga Z.	Arton Zeqiri	Nr. i biznesit	811454636

3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji: SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore (zbatues) të nevojshme për Komunën e Fushë Kosovës 612-26-4551-2-1-1

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër) b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfituesi	KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
Adresa	Objekti i ri i Komunës, rr. "Tahir Zemaj" nr.2 (afër QKMF-së)
Shuma e siguruar €	15,000.00 €

4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Policë.
- Efekt i veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thotë fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfituesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thotë se Përfituesi nuk mund të paraqesë kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit për përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Përfituesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi tek Siguruesi / Garantuesi)

Periudha e sigurimit/garancisë Fillon me: 31.07.2026 Mbaron me: 29.08.2028

5

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
15,000.00 €	562.19 €	101.19 €	663.38 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht
Premium is paid completely 663.38 € Datë 31.07.2026 Me këtë: Numri i kështeve
In Installments:Nr. of Inst.

Shënime tjera:

I Siguruari / The Insured	Data e lëshimit / Issued date	Siguruesi / The Insurer
Arton Zeqiri	31.07.2026	Përparim Muja



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **DEA GROUP SH.P.K. , Rr. Prekazi 36 Prishtine**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore (zbatues) të nevojshme për Komunën e Fushë Kosovës
612-26-4551-2-1-1

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Pesëmbëdhjetë mijë 15,000.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **15,000.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **760 ditë prej 31.07.2026 deri më 29.08.2028**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.



Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
31.07.2026

AUTORITETI KONTRAKTUES

**KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, Objekti i ri i Komunës, rr. "Tahir Zemaj" nr.2 (afër QKMF-së),
12000, Fushë Kosovë,**

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 612-26-4551-2-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **DEA GROUP SH.P.K., PRISHTINE, 10000, KOSOVO, Kosovë**

E-mail: **deagroup0@gmail.com**

Personi kontaktues: **ARTON ZEQRIRI**

Telefoni: **044815477**

Faxi:

Numri fiskal: **811454636**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):